



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1132 Prot

Tiranë, më 29/09/2023

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar neni 9 pika 1, gërma ç; neni 13 e në vijim; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Institucionit të TKOBAP-së me nr.1850 prot datë 25.07.2014; të shpallë 1 vend vakant për pozicionin e punës:

❖ **Solist i Parë Lirik - zëri (tenor) pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë:**

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme për vendin vakant Solist i Parë Lirik - zëri (tenor) pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë.

-Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje e çertifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Të gjithë artistët që janë të interesuar për t’iu nënshtruar audicionimit, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së deri në datën 31/10/2023, ora 16:30 dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

Dokumentacioni:

1. Të ketë kryer studimet e larta mastër diploma (kanto) brenda ose jashtë vendit;
2. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
4. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore, ose një dokument ekuivalent me të;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore, ose një dokument ekuivalent me të;
7. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria në vite e çertifikuar, mastër class, Work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, experience pune për vendin që aplikon, tituj artistik etj). Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter;
8. Të ketë njohuri minimalisht të 2 gjuhëve të huaja, të detyrueshme italisht dhe anglisht.

Audicioni do të zhvillohet në dy faza si më poshtë vijon:

Faza I:

Audicioni për vendin vakant Solist i Parë Lirik - zëri (tenor) pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë do të mbahet në ambientet e Hollit Koncertor kati i II i TKOBAP me adresë: “Sheshi Skënderbej” Tiranë, në datën 7/11/2023, ora 14:00 sipas programit të konkurimit si më poshtë cituar.

Faza II:

Kandidatët e përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit pas përfundimit të fazës së I do të lajmërohen nëpërmjet adresës së tyre të e-mailit për t’u paraqitur në ambientet e Hollit Koncertor kati i II i TKOBAP me adresë sheshi “Skënderbej”, Tiranë, në datën 10/11/2023, ora 16:00 për të konkuruar sipas programit të konkurimit si më poshtë cituar:

***Programi për konkurimin në të dyja fazat është interpretimi i roleve (përzgjedhja e roleve për interpretimin nga kandidatët gjatë dy fazave të audicionit do të bëhet Komisioni i Vlerësimit) nga veprat e mëposhtme:**

“Tosca”;

“La Boheme”;

“Turandot”;

“Madama Butterfly”;

“Il Trovatore”

“Aida”;

“Carmen”;

“Messa Da Requiem” Verdi;

“Luisa Miller”;

“Attila”;

“Cavalleria Rusticana”;
“Pagliacci”;
“La Forza del Destino”.

***Lexim “A prima vista” i një arie nga literatura e repertorit operistik;**

*** Vlerësim në bazë të diskutimit motivues (me gojë) me komisionin vlerësues;**

***Solfezh ritmik dhe melodik “A prima vista” sipas kërkesës së Komisionit.**

Shënim:

-Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

-Nëse kandidatët nuk kanë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor do vendosë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar minimalisht 3 javë përpara.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:
sekretaria@tkob.gov.al Etrita.Ibrahimi@tkob.gov.al

**MIRATOI
DREJTORE E PËRGJITHSHME
Abigeila VOSHTINA**

